

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË GJATË VITIT 2022

Organizimi i konferencave dhe akademive solemne

Gjatë vitit 2022 Instituti i Historisë ka shënuar disa jubile të rëndësishme duke organizuar konferenca shkencore dhe akademi solemne, të cilat kishin si synim shënimin e disa ngjarjeve dhe personaliteteve të rëndësishme historike, duke sjellë rezultate të reja në fushën e historiografisë sonë:

- Më 7 dhe 8 prill 2022, Instituti i Historisë në bashkëpunim me Instituti i Historisë-Tiranë dhe Institutin Albanologjik-Prishtinë organizoi Konferencën shkencore: “Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX”, në të cilën rezultatet e tyre i prezantuan 66 studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Kumtesat e prezantuara në këtë Konferencë shkencore kishin për objekt studimi gjenocidin serb ndaj popullit shqiptar përgjatë shekujve XIX dhe XX, me theks të veçantë gjenocidin serb ndaj popullit shqiptar në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, konkretisht gjatë luftës në Kosovë.

-Në përvjetorin e 55 të themelimit, Instituti i Historisë, më 4 nëntor 2022, organizoi Akademinë solemne, ku me fjalë përshëndetëse morën pjesë udhëheqës dhe përfaqësues të institucioneve shkencore e kulturore nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

- Instituti i Historisë, në cilësinë e bashkorganizatorit me Institutin për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup dhe Shtëpinë Botuese “Drita”, më 5 dhjetor 2022 në Shkup, mbajtën Konferencën: “Ditët e Bogdanit”, ku me kontributet e tyre u paraqitën studiues nga institucionet shkencore e akademike të hapësirave të ndryshme shqiptare, të cilët me shumë pasion, korrektësi dhe saktësi shkencore e profesionale iu kanë qasur temave të cilat i prezantuan duke kapur segmente të rëndësishme nga veprimtaria shkencore, politike e

sidomos ato që ndërlidhen me çështjen kombëtare, për të cilat Pjetër Bogdani u dallua gjatë gjithë veprimtarisë së tij.

-Në cilësinë e bashkorganizatorit me Institutin për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup dhe Shtëpinë Botuese “Drita”, më 6 dhjetor 2022 në Prishtinë, mbajtën Akademinë solemne: “Ditët e Bogdanit”, ku me fjalë përshëndetëse u kujtua jeta dhe veprimtaria shkencore e atdhetare e Bogdanit.

Veprimtaria botuese

Veprimtaria botuese e Instituti të Historisë gjatë vitit 2022 ishte e fokusuar në botimin e monografive si të studiuesve të Institutit ashtu edhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm të tij, si dhe përmbledhjeve me punime dhe kumtesa nga konferencat shkencore. Si rezultat i kësaj, përgjatë vitit 2022 u botuan si dhe janë në proces botimi, këta tituj:

1. *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë, 1912-1990*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
2. *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë dokumente historike I, 1912-1944*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
3. *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë, dokumente historike II, 1945-1958*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
4. *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë, dokumente historike III, 1959-1971*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
5. *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë, dokumente historike IV, 1972-1990*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
6. *The development of the albanian press in SFR Yugoslavia: (1974-1991): (cultural, educational and scientific aspects*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
7. *Katalogu i botimeve të Institutit të Historisë: 1967-2022*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
8. *Studime dhe vështrime historike*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
9. *“Bota ilire në ekspeditën e Jul Cezarit”, Studim i mbështetur në librin e tretë të veprës së Jul Cezarit, “Mbi luftën civile”, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.*
10. *Sanxhaku i Nishit gjatë periudhës osmane (shek. XIX)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.
11. *Rugova: kryengritja dhe masakrat më 1918-1919*, (Kumtesa të simpoziumit shkencor “100-vjetori i kryengritjes dhe i masakrave

të Malit të Zi e të Serbisë në Shtupeq dhe në katunde të tjera të Rugovës, më 1919”, Pejë, më 15 shkurt 2019), Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.

12. *Nga thesari historik dhe kulturor i Fan S. Nolit - shkresa, memorandumë, raporte diplomatike dhe korrespondencë 1927-1946*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.

Revista

Në kuadër të publikimeve shkencore, Instituti i Historisë një herë në vit publikon revistën shkencore “Kosova”. Viti 2022 është vit jubilar për revistën “Kosova”, ngase në këtë vit kjo revistë shënon 50-vjetorin e botimit, me gjithsejtë 47 numra të cilët kanë dalë përgjatë viteve 1972-2022. Me një traditë gjysmëshekullore, edhe numri i 47 i revistës “Kosova”, ka vazhduar traditën e publikimit të artikujve shkencorë, materialeve, recensioneve si dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore, të cilat prezantojnë rezultatet e punës kërkimore-shkencore në radhë të parë të studiuesve të Institutit të Historisë si dhe të bashkëpunëtorëve të tij, duke trajtuar tema që nga periudha antike e deri tek ajo bashkëkohore.

Hulumtimet shkencore në arkiva

Gjatë vitit 2022 studiuesit e Institutit të Historisë, kanë kryer hulumtime kryesisht në Kosovë dhe Shqipëri në këto arkiva: Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Arkivin Qendror të Shtetit dhe Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë.

Pjesëmarrja e studiuesve në konferenca dhe simpoziume shkencore

Studiuesit e Institutit të Historisë, në vitin 2022 ishin pjesëmarrës në disa konferenca dhe simpoziume shkencore si brenda ashtu edhe jashtë vendit, në të cilat trajtuan tema nga periudha të ndryshme të historisë, si: “*Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX*”, organizuar nga Instituti i Historisë në Prishtinë (prill 2021); *Ditët e Alfabetit - Edicioni IV*, “*Studimet albanologjike në gjuhën gjermane*”, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup (nëntor 2021); “*Ditët e Bogdanit*” organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, Instituti i Historisë dhe Shtëpia Botuese “Drita”, (dhjetor 2021); *Edicioni i 5-të i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare të Ballkanologjisë “Ballkani dhe globalizimi*”,

Organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, (tetor 2022), *Fan S. Noli - personalitet i gjithanshëm*, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (qershor 2022), *5th International Multidisciplinary Scientific Conference 2022* organizuar nga The Institute of American Studies 10.12.2022, *International Conference on the Archaeology of the Balkans From Prehistory to the End of Antiquity, Recent Discoveries and New Methods* organizuar nga Universiteti i Prishtinës (nëntor 2022), *110-vjetori i Kryengritjes së Përgjithshme dhe shtetit të pavarur shqiptar: roli i Hasan Prishtinës*, organizuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Filozofik & Komuna e Vushtrrisë (qershor 2022), *Conference proceedings ICSNS XXII - 2022 Twenty-second international conference on: "Social and natural sciences - global challenge 2022"* (qershor 2022) organizuar nga International Institute for Private - Commercial and Competition Law (Austria) in Partnership with Bielefeld University of Applied Sciences (Germany), Keiser University (USA), Institute of History and Political Science of the University of Białystok (Poland) and School of American Law (Greece), *"Vatra" - 110 vjet në shërbim të atdheut dhe kombit shqiptar*", organizuar nga Federata Pan-Shqiptare e Amerikës "Vatra", Nju Jork, USA, (qershor 2022), *Albanologu kroat Milan Shuflaj* (maj 2022 Ulqin), *Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992*, organizuar nga ASHAK, (maj 2022), *"Jeta dhe vepra e Gjon Nikollë Kazazit"*, (qershor 2022), *International Conference: Communist myths, before and after the system change, Institute for Democracy, Media and Cultura; Konrad Adenauer Stiftung*, (shkurt 2022), *6th International Congress of Eurasian Social Sciences*, (maj 2022), *"Ushtria Çlirimtare e Kosovës - vlerë kombëtare e Kosovës"* organizuar nga Instituti Albanologjik-Prishtinë, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, (mars 2022), *110-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. Rrugëtimi shqiptar për Pavarësinë*, organizuar nga Akademia e Shkencave, Tiranë (nëntor 2022), *Simposium i pestë shkencor për LËVIZJEN: "Lëvizja e viteve 1990-1991 dhe shpërbërja e Jugosllavisë"*, (dhjetor 2022), *"Rruga e shqiptarëve drejt pavarësisë dhe sfidat e procesit të shtetndërtimit"*, (nëntor 2022), *"110 vjet nga Pavarësia e Shqipërisë"*, (nëntor 2022) (tetor 2021); dhe *"Kuvendi III i studimeve albanologjike"* në Tiranë (nëntor 2021), etj.

Botime shkencore në revista kombëtare e ndërkombëtare

Rezultatet e tyre shkencore, studiuesit e Institutit të Historisë i prezantuan në revista të ndryshme shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si në: *Kosova, Studime historike, Gjurmime albanologjike, Studime shoqërore, Dituria islame, SEEU Review, Anglisticum. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, Balkanjournal, Economy and Society, Journal of History and Future, Journal of Positive School Psychology, Challenge 2022*, *Vakaniivis - Uluslararası Tarih Araştırmaları Dergisi / International Journal of Historical Researches, Balkanistic Forum, Journal of Islamic Architecture* etj.

Projektet shkencore kolektive dhe individuale

Gjatë vitit 2023, Instituti i Historisë do të vazhdojë punën në finalizimin e vëllimeve të projektit “Historia e Kosovës”. Po ashtu, punonjësit shkencorë të Institutit të Historisë do të fokusohen në projektet individuale për periudhën 4-vjeçare, si dhe në vazhdimin e hulumtimeve rreth projektit kolektiv: “Gjenocidi serb në Kosovë, 1877-1999”. Gjithashtu, disa studiues nga Instituti i Historisë janë angazhuar në projektin “Historia e shqiptarëve”, projekt i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

Të arriturat tjera

Instituti i Historisë gjatë vitit 2022 ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Historisë në Tiranë, në fushën kërkimore-shkencore, në kuadër të të cilës do të përfitojnë profesionalisht studiuesit e të dy instituteve.

Prioritetet për vitin 2023

Për vitin 2023 prioritet i Institutit të Historisë do të jetë:

- a. vazhdimi i punës në vëllimet “Historia e Kosovës”, në kuadër të projektit shkencor të Institutit të Historisë në Prishtinë;
- b. vazhdimi i punës në projektin “Gjenocidi serb në Kosovë, 1877-1999”;

- c. vazhdimi i botimit të monografive dhe përmbledhjeve me dokumente të cilat janë paraparë për vitin 2023;
- d. organizimi i konferencave dhe simpoziumeve shkencore duke shënuar data dhe tematika të veçanta;
- e. vazhdimi i zgjerimit të bashkëpunimit me institucione kërkimore-shkencore e universitare si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Teuta SHALA-PELI